

Titulli : Nëna e Peccoros dhe ditët e saj



Regjisor: Azuma MORISAKI

Aktorët: Ryo IWAMATSU / Harue AKAGI / Kiwako HARADA / Ryo KASE / Naoto TAKENAKA / Tomoyo HARADA / Yoichi NUKUMIZU

Çmime: Festivali i Filmit Kali i Artë Taipei 2014

Yuichi Okano është një “baby boomer” i lindur dhe rritur në Nagasaki. Ai është aq shumë i dhënë pas hobeve të tij – vizatimit të mangave dhe performimit si muzikant - sa që ka lënë pas dore punën e tij si përfaqësues shitjesh i reklamave të revistave.

“Do të shkojë mirë, sigurisht që do të shkojë mirë. Po ju them se do të ndodhë...” teksa ai performon i lumtur këngën e tij origjinale në një kafene, një zile telefoni i ndërpret performancën. Ai i hedh një vështrim të indinjuar audiencës së tij, por ai që bie është celulari i tij, dhe ajo që e telefonon është nëna e tij, Mitsue, e cila i thotë se disa punëtorë kanë shkuar në shtëpi për të bërë disa punime në sistemin e kanalizimeve. Duke qënë se ajo ka rënë pre e mashtrimeve të ndryshme në shumë raste, dhe ky padyshim është një tjetër mashtrim, ai i bërret asaj të mos u japë para, ndërkohë që heq kapelën duke ekspozuar kokën e tij tullace që duket si një pecoross - një qepë e

vogël. Demenca e Mitsue filloi të shfaqet menjëherë pasi burri i saj, Satoru, vdiq 10 vjet më parë. Ajo del për të blerë pak sake për Satorun dhe nipi e kthen në shtëpi, ndërsa pret që Yuichi të kthehet në shtëpi dhe të parkojë në hapësirën e tij të parkimit gati sa nuk e përplas makina, ajo mbush sirtarët e saj me të brendshme të papastra ... duke parë shumë sjellje inkoherente, kujdestari i Mitsues bind Yuichin ngurrues se ka ardhur koha që ta çojë në një qendër përkujdesi.

Qendra e përkujdesit ku ajo hyn është e mrekullueshme, megjithatë, kur të gjithë pacientët bëhen bashkë për të marrë pjesë në aktivitete të tilla si këndimi. Matsu, që sillet si një gjimnaziste e dashuruar; Yuri, i cili besdis të gjithë banorët duke u kërkuar karamеле; dhe Yojiro, i cili u prek gjoksit kujdestareve bukuroshe, të gjithë pacientët me personalitetet e tyre të çuditshme e të mrekullueshme, mirëpresin me gëzim Mitsuen, por, ajo mbyllet në dhomën e saj për të qepur rroba të padukshme, duke thënë se duhet të rregullojë kostumet e Satorut.

Mitsue ishte më e madhja e 10 vëllezërve dhe motrave, kështu që ishte detyra e saj të arnonte kimonot e vëllezërve dhe motrave të saj më të vegjel, të konsumuara nga puna e tyre në ara. Edhe pasi u martua, ajo u përball me kohë të vështira, sepse Satoru shpenzonte rrogën për të blerë alkool dhe rrjedhimisht kostumet e tij dhe rrobat e fëmijëve të tyre kishin të gjitha qepje dhe arnime.

Kujtimet e Mitsue duket se gradualisht po kthehen në të shkuarën e saj. Një ditë, ajo thotë se Satoru, shoku i saj i fëmijërisë Chi-chan dhe motra e saj më e vogël, Takayo, e cila ka vdiq në moshën tetë vjeçare, kanë ardhur për ta vizituar. Ndërsa Yuuichi përgjigjet thjesht me, "ashtu?", ajo thotë, se "ata vijnë të më shohin më shpesh pasi kanë vdekur". Me këtë, Yuuichi mendon se të harruarit mund të mos jetë edhe aq gjë e keqe.